

FORMULAR

PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT NGA FONDI I PRODHIMIT TË PAVARUR

- I. Titulli i Projektit: _____
- II. Aplikuesi:
1. Person Fizik
 2. Person Juridik
 3. Emri : _____
 4. Adresa : _____
 5. Tel/E-mail : _____
 6. Person kontakti : _____
- III. Objekti: Financim i prodhimit të programeve të pavarura të transmetimit audioviziv
- IV. Forma e prodhimit: Prodhim i porositur
- V. Lloji i prodhimit audioviziv: Prodhim filmik
Serial televiziv
- VI. Numri i serive televizive: 10 (dhjetë)
- VII. Kohëzgjatja e një serie televizive: 40 (dyzetë) minuta deri në 45 (dyzetëpesë) minuta
- VIII. Fondi financiar: 10,000,000.00 (dhjetëmilionë) lekë
- IX. Natyra e Serialit televiziv: Serial televiziv komiko - social, që prek problematikat në Shqipëri, trajtuar me nota humori.
- X. Grup – mosha: Për të gjitha moshat
- XI. Vendi i prodhimit: Republika e Shqipërisë
- XII. Gjuha: Gjuha shqipe

XIII. Afatet e prodhimit:	90 (nëntëdhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës me RTSH
XIV. Periudha e transmetimit:	Transmetimi i parë i serisë televizive të parë: muaji Prill 2021
XV. Formati i prodhimit:	16:9, Full HD, 4K, Sony – f55 – cinelata – 4K
XVI. Audio:	Stereo
XVII. Ngjyrat:	Me ngjyra
XVIII. Të drejtat:	Radio Televizioni Shqiptar zotëron të gjitha të drejtat e shfrytëzimit të secilës prej 10 (dhjetë) serive televizive të Serialit televiziv
XIX. Forma e të drejtave:	Ekskluzive
XX. Kohëzgjatja e të drejtave:	E pakufizuar
XXI. Territori:	Republika e Shqipërisë si dhe territoret e të gjithë shteteve të Botës
XXII. Numri i transmetimeve :	I pakufizuar

XXIII. PËRSHKRIMI I NARRATIV I PROJEKTIT

Përmes gjubës përshkruese, jepen të dhëna të përgjithshme të historisë apo ngjarjes që do të materializohet në serialin televiziv,

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi, është synimi i përgjithshëm, afatgjatë, që kërkohet të arrihet përmes serialit televiziv si dhe objektivat janë synimet e veçanta, afatshkurtër, që planifikohen të realizohen përmes serialit televiziv.

ANËT POZITIVE

Lidhen me karakterin edukues dhe argëtues për audiencën, të cilës i drejtohet seriali televiziv.

Lidhen me karakterin inspirues dhe reagues kryesisht për moshat aktive të shoqërisë.

Lidhen me pasqyrimin e traditës, kulturës dhe artit shqiptar në përmbajtjen e serialit televiziv.

ANËT NEGATIVE

Lidhen me shfaqjen në përmbajtjen e serialit televiziv të diskriminimit dhe gjubës së urrejtjes në baza etnike, fetare, kulturore, gjinore, gjubësore, të cilat janë të dëmshme për shoqërinë.

XXIV. Projekt – preventivi financiar i buxhetit të projektit i detajuar në zëra të veçantë

Është parashikimi i shpenzimeve financiare të projektit - prodhim filmik, serial televiziv, që pasqyrohet në një tabelë, i strukturuar në bazë të zërave të shpenzimeve të deklaruara në preventivin financiar të buxhetit të projektit – prodhim filmik, serial televiziv.

XXV. Sqarime në lidhje me dokumentacion tjetër të nevojshëm, që kërkohet

1. Skenari/sinopsi i projektit;

Skenari i serialit televiziv mund të jetë letrar ose tekniko – regjisorial. Sinopsi është draf i parë i një skenari, i cili lejon që të konstatohen lehtësisht çështjet kryesore të tij si dhe lejon që të identifikohen struktura qendrore e veprës dhe qëllimet kryesore të saj. Skenari/sinopsi duhet të jetë i shkruar në gjuhën shqipe dhe i printuar në format A4.

2. Stafin e parashikuar për realizimin e projektit;

Tërësia e personave pjesëmarrës në projektin e prodhimit filmik, serialit televiziv, apo të përfshirë në në përgatitjen e tij.

3. Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit ose Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit, i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), të mos jetë më i vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;

Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit ose Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit mund të merret pranë sporteve të QKB, ose Ekstrakti i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit ose Ekstrakti Historik i Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit mund të merret nga sistemi i QKB përmes shkarkimit online me vulë elektronike me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik i Qendrës Kombëtare të Biznesit.

4. Çertifikata e regjistrimit e personit të tatueshëm për personin fizik të interesuar ose për personin juridik të interesuar, të mos jetë më e vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;

Është certifikata NIPT ose NUIS, e cila merret nga sistemi i QKB përmes shkarkimit online me vulë elektronike me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik i Qendrës Kombëtare të Biznesit.

5. Dokument i lëshuar nga Administrata Tatimore e Shqipërisë, përmes të cilës vërtetohet se personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar nuk ka detyrime tatimore të papaguara. Dokumenti të mos jetë më i vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;

Dokumenti mund të merret pranë sporteve të Administratës Tatimore të Shqipërisë ose mund të merret përmes shkarkimit online me vulë elektronike me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik i Administratës Tatimore të Shqipërisë.

6. Dokument i lëshuar nga Administrata Tatimore e Shqipërisë, përmes të cilës vërtetohet se personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar nuk ka detyrime për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Dokumenti të mos jetë më i vjetër se 10 (dhjetë) ditë, nga data e paraqitjes së kërkesës në Sektorin e Projekteve;

Dokumenti mund të merret pranë sporteve të Administratës Tatimore të Shqipërisë ose mund të merret online me vulë elektronike me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik i Administratës Tatimore të Shqipërisë.

7. Leja e Produksionit e personit fizik të interesuar ose e personit juridik të interesuar, e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Kinematografisë së Shqipërisë, e cila duhet të jetë e vlefshme;

8. Vërtetim i lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, përmes të cilës vërtetohet se për personin fizik të interesuar ose për personin juridik të interesuar, sipas regjistrave të gjykatës nuk rrezulton që të ketë proces gjyqësor civil me RTSH;

9. Vërtetim i lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, që personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar nuk ka procedim penal të regjistruar në ngarkim të tij;
10. Deklaratë noteriale përmes të cilës personi fizik i interesuar ose personi juridik i interesuar merr përsipër të gjitha detyrimet në lidhje me të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të për përdorimin e veprave në projekt;
Deklarata noteriale bëhet nga personi fizik i interesuar ose nga personi juridik i interesuar.
11. CV e personit fizik të interesuar ose e personit juridik të interesuar;
12. Vendi i realizimit të projektit;
Është vendi (shteti) në të cilin realizohet prodhimi filmik, seriali televiziv.
13. Deklaratë e personit fizik ose juridik që:
 - (i) personat pjesëmarrës në program, apo të përfshirë në në përgatitjen e tij dhe pajisjet e mjetet për realizimin e programit vendosen nga vetë personi fizik ose juridik;
 - (ii) nuk është një transmetues audioviziv, pjesë e tij, apo aksionar në një transmetues;*Deklarata nënskruhet nga përfaqësuesi i personit fizik ose nga përfaqësuesi i personit juridik, në cilësinë e administratorit.*